



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U "Nënë Tereza" kërkon të punësojë **1 (një) Administrator Spitalor në Polet e Administrimit të Integruar**, të QSU "Nënë Tereza".

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Administrator Spitalor :

- Arsim i Lartë. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të ketë te pakten 2 vjet përvojë pune në pozicion drejtues/administrues/menaxhues;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Të ketë njohuri shumë të mira për shërbimet shëndetësore;
- Të ketë aftësi shumë të mira në menaxhimin e konflikteve;
- Të jetë i/e aftë të koordinojë punën e administratës së PAI me shërbimet mjekësore
- Të jetë i/e aftë të koordinojë punën në shërbime sipas të gjithave rregullave, normave dhe orientimeve të vendosura nga institucioni;
- Të jetë i/e aftë të sjellë ide kreative në lidhje me menaxhimin e PAI;
- Të jetë i/e aftë të punojë në grup;
- Të jetë i/e aftë të drejtojë dhe të vlerësojë punën e stafit nën varësi;
- Të ketë njohuri shumë të mira të procedurave administrative;
- Aftësi të mira në komunikim dhe prezantim.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentata në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV), në gjuhën shqipe
3. Diplomën/at e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (link <http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU "Nënë Tereza" duke nisur nga data **01.11.2021 ora 08:00** deri më **15.11.2021 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE